



Komisioni i
Pavarur i
Kualifikimit

NJOFTIM MBI SEANCËN E SHPALLJES SË VENDIMIT PËR SUBJEKTIN E RIVLERËSIMIT ZNJ. IRENA ÇUNOTI (QELESHI)



18/07/2024

Komisioni i Pavarur i Kualifikimit njofton se pas shqyrtimit të dokumentacionit dhe zhvillimit të seancës dëgjimore në datën 17.7.2024, për subjektin e rivlerësimit, znj. Irena Çunoti (Qeleshi) bazuar në ligjin nr. 84/2016, vendosi:

Konfirmim në detyrë të subjektit të rivlerësimit, znj. Irena Çunoti (Qeleshi), prokurore në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë.

Vendimi, i arsytuar me shkrim, nga trupi gjykues i kryesuar nga znj. Genta Tafa Bungo, znj. Etleda Çiftja relatores, z. Roland Ilia anëtar do t'i njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë brenda 30 ditëve.

Ky vendim, mund të ankimohet në Kolegjin e Posaçëm të Apelit nga subjekti i rivlerësimit dhe/ose Komisioneri Publik 15 ditë nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit.

Ankimi depozitohet në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit.

Ky vendim u shpall sot, në datën 18.7.2024

**Informacioni është aksesuar në faqen e KPK datë 19.07.2024 në linkun: <https://kpk.al/njoftim-mbi-seancen-e-shpalljes-se-vendimit-per-subjektin-e-rivleresimit-znj-irena-cunoti-geleshi/28/>*

